

# PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKFCP

Tiranë më 10.10.2022

Sot më datë, 10/10/2022 u mbledh Asambleja e Përgjithshme e Agjencisë së Administrimit Kolektiv Faber Collective Phonogram, në selinë e Agjencisë me adresë: Rr. "Dervish Hima", Hyrja 1, Ap. 50, ZK. 8160, Nr. Pasurie 6/410+1-50, Vol 42, Fq. 18, Tiranë, sot më datë 04.11.2022 në prezencë të përfaqësuesve të Asamblesë së Përgjithshme e përbërë nga themeluesit e Shoqatës (i) Faber Media sh.p.k, Ortakut të Vetëm zj. Anxhela Faber, dhe (ii) Faber Digital sh.p.k, Ortakut të Vetëm zj. Anxhela Faber, Kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme zj. Anxhela Faber, Sekretarit të Asamblesë së Përgjithshme zj. Xhensila Zhoga, ku u diskutuan dhe vendosën sa më poshtë vijon:

1. Nga kryetari i mbledhjes u verifikua prezenca e pjesëmarrësve anëtar të Asamblesë, të cilët ishin të gjithë të pranishëm dhe të cilët deklaruan të gjithë se kishin marrë njoftim brenda afatit në adresat respektive të shoqërive.
2. U vendos caktimi i z. Xhensila Zhoga si Sekretar i Asamblesë së Përgjithshme;
3. U miratua rendi i ditës sipas propozimit të Presidentit të Këshillit të Administrimit, pa asnjë kundërshtim;
4. U vendos shkarkimi i anëtarit të Këshillit të Administrimit z. Aldor Nini, në cilësinë e Financierit dhe anetarit të Këshillit Drejtues.
5. U propozua dhe u vendos emërimi i znj. Vanesa Likaj, Financier për një afat 3 vjeçar;
6. U vendos ndryshimi i Statutit të Agjencisë së Administrimit Kolektiv Faber Collective Phonogram në nenin 10.8 të saj me përmbajtjen si më poshtë vijon:  
"10.8 Anëtarët e parë të Këshillit të Administrimit, zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme".
7. U vendos caktimin si përfaqësues ligjor të Studios Ligjore "T&N" sh.p.k me NIPT L81717029G, për të kryer procedurat e regjistrimit të ndryshimeve statutores sipas autorizimit që u lëshua nga anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme të AAKFCP.
8. U vendos që të ngarkohet Sekretari i Mbledhjes:
  - të njoftoj z. Aldor Nini mbi shkarkimin nga detyra e Financierit të Këshillit të Administrimit;
  - të njoftoj znj. Vanesa Likaj mbi emërimin e tij Financier i Këshillit të Administrimit të AAKFCP;
  - të njoftoj dhe përcjellë dokumentacionin e kësaj mbledhje pranë Studios Ligjore "T&N" sh.p.k me adresë Rr. "Perlat Rexhepi", Rezidenca Ivanaj, Nr. 19, Kt. 7, Ap. 52, Tiranë, për të vijuar me procedurat ligjore sipas parashikimeve të ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jo fitimprurëse", i ndryshuar dhe ligjit nr. 80/2021 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse".




9. Në përfundim u nënshkruan aktet respektive nga pjesëmarrësit në Asamblenë e Përgjithshme në dakordësi të plotë dhe pa kundërshtime.

KRYETAR I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

ANXHELA FABER

Anxhela Faber

(emër/mbiemër/firmë/vulë)



Sekretar i Asamblesë së Përgjithshme

Xhensila Zhoga

(emër/mbiemër/firmë)

Zhoga



Nr. \_\_\_\_ .Prot

Datë 10/10/2022

### AUTORIZIM

Sot më datë **10.10.2022**, Shoqata "Agjencisë së Administrimit Kolektiv Faber Collective Phonogram", person juridik me seli Rr. "Dervish Hima", Hyrja 1, Ap. 50, ZK. 8160, Nr. Pasurie 6/410+1-50, Vol 42, Fq. 18, Tiranë, përfaqësuar nga anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme:

1. "Faber Digital" sh.p.k me nr. NUIS L62207020H me Ortak të Vetëm zj. Anxhela Faber e datëlindjes 20.11.1991, atësia Edmond, amësia Estela, me nr. Id J16120041A,
2. "Faber Media" sh.p.k me nr. tregtar Identifikues 811395624 me Ortak të Vetëm Anxhela Faber e datëlindjes 20.11.1991, atësia Edmond, amësia Estela, me nr. Id J16120041A,

Autorizojnë Studion Ligjore "T&N" sh.p.k me NIPT L81717029G me administrator AV. Plarent NDRECA, për të vijuar me procedurat ligjore, sipas parashikimeve të ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jo fitimprurëse", i ndryshuar dhe ligjit nr. 80/2021 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse", duke e autorizuar si përfaqësues të posacëm për kryerjen, në emër e për llogari të shoqatës, të kësaj porosie:

- i. Të përfaqësojë shoqatën edhe në mungesën të gjithë procedurat apo proceset administrative, gjyqësore civile apo penale pranë gjithë institucioneve shtetërore ose private, pranë Gjykatës Administrative, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Gjykatës së Apelit, Apelit Administrativ, Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, në mbrojtje të interesave që lidhen me vendimin nr. 1, datë 10.10.2022 të Asamblesë së Përgjithshme të AAKFCP, dhe konkretisht regjistrimin e ndryshimeve statutore të miratuara në mbledhjen e datës 10.10.2022.
- ii. Studios i japim të drejta të plota për çdo kërkim tjetër që mund të lind, në zbatim të të drejtave dhe detyrimeve statutore të Shoqatës "Agjencia e Administrimit Kolektiv Faber Collective Phonogram", duke i ndjekur në të gjitha instancat gjyqësore dhe administrative.
- iii. Studios i japim gjithashtu të drejta të plota të paraqesë dhe nënshkruajë padi, kundërpadi, të prapësojë dhe të kundërshtojë palët kundërshtare në gjykim, të drejtë të paraqitjes së kërkesave të cdo lloji, emërim apo kundërshtim ekspertësh, paraqitja e provave shkresore e dëshmitarëve, dhe kundërshtimi i të tillëve prej palëve kundërshtare, të drejtën e ankimit, rekursit, dhe cdo veprim tjetër që i njeh ligji procedural civil në lidhje me objektin e parashikuar në pikën (i) të kësaj prokure.
- iv. Gjithashtu studio ka të drejtë të paraqesë prova, kërkesa të ndryshme, pranë gjithë institucioneve shtetërore apo enteve private, të kërkojnë dhe të marrin kopje të dokumentacionit dhe çdo lloj informacioni që ka të bëjë me çështjen e sipërcituar.



- v. Studios i jap të drejtë që në emër dhe për llogari të shoqatës të ndjekin proceset deri në marrjen e vendimeve të formës së prerë dhe përfaqësimin pranë zyrës së përmbarimit deri në ekzekutim të vendimit dhënë në favor të shoqatës nëse do të lind nevoja.
- vi. Studio ka të drejtë të caktojë edhe avokat të tjerë që punojnë/ bashkëpunojnë me të për të ndjekur çështjen sipas tagrave më sipër dhe realizimin e porosisë.
- vii. Me anë të këtij akti Studios i japim të drejtë të kryejë edhe çdo veprim që nuk është thënë shprehimisht në prokurë, por që ka lidhje me plotësimin e porosive të mësipërme.

Të gjitha veprimet e kryera prej përfaqësuesve i konsiderojmë të drejta dhe të mirëqena njëjloj sikur të ishin vetë të pranishëm anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme të AAKFCP. Ky autorizim u përpilua në 3 (tre) kopje në bazë të neneve 70, 72 e vijues të Kodit Civil dhe do ta ketë vlefshmërinë e tij deri në lëshimin e një autorizimi të ri ose deri në mbarimin dhe kryerjen e kësaj porosie.

#### ANETARET E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

1. Faber Media sh.p.k \_\_\_\_\_ *Anxhela Faber*  
(emër/mbiemër/firmë/vulë)

2. Faber Digital sh.p.k \_\_\_\_\_ *Anxhela Faber*  
(emër/mbiemër/firmë/vulë)





Tiranë, më 23.09.2022

**Lënda:** Njoftim mbledhje Asambleja e Përgjithshme e Agjencisë së Administrimit Kolektiv Faber Collective Phonogram

**Drejtuar:** Zj. Anxhela Faber, Administrator  
"Faber Media" sh.p.k me nr. tregëtar Identifikues 811395624  
Adresa: Rr. Agim Ramadani nr. 292, 3, Prishtinë

**PRISHTINË**

Zj. Anxhela Faber, Administrator  
"Faber Digital" sh.p.k me nr. NUIS L62207020H  
Adresa: Rr. "Dervish Hima", Hyrja 1, Ap. 50, ZK. 8160, Nr. Pasurie 6/410+1-50, Vol 42, Fq. 18

**TIRANË**

**Baza ligjore:** - Neni 8 i Statutit të Shoqatës "Agjencia e Administrimit Kolektiv Faber Collective Phonogram", miratuar më dt. 19.11.2020, akti noterial nr. 4120 rep., nr. 833., kol.  
- Ligji nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jo fitimprurëse", i ndryshuar.

*Të nderuar anëtarë të Asamblesë së Përgjithshme,*

Në mbështetje të detyrave funksionale dhe në cilësinë e organit më të lartë vendimarrës referuar Statutit të Shoqatës "Agjencia e Administrimit Kolektiv Faber Collective Phonogram", miratuar në datën 19.11.2020, në zbatim të nenit 8 të tij dhe po ashtu brenda kuadrit rregullator që parashikon ligji nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jo fitimprurëse", i ndryshuar, në datën 10.10.2022 ora 10:00 në selinë e Agjencisë në adresën Rr. "Dervish Hima", Hyrja 1, Ap. 50, ZK. 8160, Nr. Pasurie 6/410+1-50, Vol 42, Fq. 18, Tiranë, ju ftojmë të merrni pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të AAKFC, sipas rendit të ditës, bashkëlidhur.

Duke ju falenderuar,

**PRESIDENT I KËSHILLIT TË ADMINISTRIMIT**  
**ANXHELA FABER**

*Anxhela Faber*  
(emër/mbiemër/firmë/vulë)





## **REND DITE**

**MBLEDHJA E DATËS 10.10.2022 ORA 10:00**

Asambleja e Përgjithshme e Agjencisë së Administrimit Kolektiv Faber Collective Phonogram

**Vendi:** Selia e Agjencisë së Administrimit Kolektiv Faber Collective Phonogram

*Adresa: Rr. "Dervish Hima", Hyrja 1, Ap. 50, ZK. 8160, Nr. Pasurie 6/410+1-50, Vol 42, Fq. 18, Tiranë,*

**Pjesëmarrës: Asambleja e Përgjithshme e AAKFCP**

Zj. Anxhela Faber, Ortak i Vetëm - "Faber Media" sh.p.k

Zj. Anxhela Faber, Ortak i Vetëm - "Faber Digital" sh.p.k

### **RENDI I DITËS:**

1. Shkarkimin e anëtarit të Këshillit të Administrimit z. Aldor Nini, në cilësinë e Financierit;
2. Emërimin e znj. Vanesa Likaj Financier për një afat 3 vjeçar;
3. Ndryshimin e Statutit të Agjencisë së Administrimit Kolektiv Faber Collective Phonogram në nenin 10.8 të saj;
4. Caktimin e Studios Ligjore "T&N" sh.p.k me NIPT L81717029G, me administrator z. Plarent NDRECA për të kryer procedurat e regjistrimit të ndryshimeve statutore sipas autorizimit të miratuar në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të AAKFCP.





**PRESIDENT I KËSHILLIT TË ADMINISTRIMIT**

**ANXHELA FABER**

*Anxhela Faber*

(emër/mbiemër/firmë/vulë)





## **VENDIM I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË AKFCP**

Tiranë më 10.10.2022

Asambleja e Përgjithshme e Agjencisë së Administrimit Kolektiv Faber Collective Phonogram, në selinë e Agjencisë me adresë: Rr. "Dervish Hima", Hyrja 1, Ap. 50, ZK. 8160, Nr. Pasurie 6/410+1-50, Vol 42, Fq. 18, Tiranë, sot më datë 04.11.2022 në prezencë të përfaqësuesve të Asamblesë së Përgjithshme e përbërë nga themeluesit e Shoqatës (i) Faber Media sh.p.k dhe (ii) Faber Digital sh.p.k, u njoh me rendin e ditës dhe pas vlerësimit të situatës, menaxhimit në aspektin financiar dhe brenda kuadrit rregullator, në mbështetje të:

- Nenit 8 dhe 10 të Statutit të Shoqatës "Agjencia e Administrimit Kolektiv Faber Collective Phonogram", miratuar më dt. 19.11.2020, akti notarial nr. 4120 rep., nr. 833., kol.
- Nenit 20 gërma "a" dhe "ë" të ligji nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jo fitimprurëse", i ndryshuar;
- Nenit 64 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë,

Pasi votoi pro me 100% të kuorumit të përfaqësuesve:

### **VENDOSI:**

1. Miratimin e rendit të ditës sipas propozimit të Presidentit të Këshillit Administrimit.
2. Shkarkimin e anëtarit të Këshillit të Administrimit z. Aldor Nini, në cilësinë e Financierit dhe anëtarit të Këshillit Drejtues për arsye të poshtë shënuara.
3. Emërimin e znj. Vanesa Likaj Financier për një afat 3 vjeçar;
4. Ndryshimin e Statutit të Agjencisë së Administrimit Kolektiv Faber Collective Phonogram në nenin 10.8 të saj me përmbajtjen si më poshtë vijon:





*“10.8 Anëtarët e parë të Këshillit të Administrimit, zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme”.*

5. Caktimin si përfaqësues ligjor të Studios Ligjore “T&N” sh.p.k me NIPT L81717029G, për të kryer procedurat e regjistrimit të ndryshimeve statutore sipas autorizimit bashkelidhur këtij vendimi të Asamblesë së Përgjithshme të AAKFCP.
6. Ngarkohet Sekretari i Mbledhjes:
  - të njoftoj z. Aldor Nini mbi shkarkimin nga detyra e Financierit dhe anetarit të Këshillit të Administrimit;
  - të njoftoj znj. Vanesa Likaj mbi emërimin e tij Financier i Këshillit të Administrimit të AAKFCP;
  - - të njoftoj dhe përcjellë dokumentacionin e kësaj mbledhje pranë Studios Ligjore “T&N” sh.p.k me adresë Rr. “Perlat Rexhepi”, Rezidenca Ivanaj, Nr. 19, Kt. 7, Ap. 52, Tiranë, për të vijuar me procedurat ligjore sipas parashikimeve të ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jo fitimprurëse”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 80/2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”.
7. Ky vendim hyn në fuqi sot më datë 04.11.2022.

KRYETAR I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

ANXHELA FABER

*Anxhela Faber*

(emër/mbiemër/firmë/vulë)





ANETARET E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

1. Faber Media sh.p.k Anxhela Faber

(emër/mbiemër/firmë/vulë)



2. Faber Digital sh.p.k Anxhela Faber

(emër/mbiemër/firmë/vulë)

Sekretar i Asamblesë së Përgjithshme

Xhensila Zhoga Zhoga

(emër/mbiemër/firmë/vulë)